



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.12.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 12:29.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe “online”*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)*
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. Markelian Koça (anëtar)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte EWMI-INL.

7. Klodiana Vogli, përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.

8. Arben Lila, përfaqësues i EU4JUSTICE.

9. {...}, Inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

10. {...}, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

11. Staf nga administrata e KLGJ-së.

12. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjen e datës 26.12.2023.

Siç ju kam vënë në dijeni, në rendin e ditës janë tre çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit.

Çështja e parë ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për një ndryshim në ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme.

Dhe çështja e tretë ka të bëjë me detajimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime korrente për buxhetin e vitit 2023 për sistemin gjyqësor, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik.

Atëherë, pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë.

Të thërrasim në seancë përfaqësuesin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Po nga magjistrati ka ardhur përfaqësim?

(Futet në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Naureda Llagami: Përpara nesh është paraqitur si përfaqësuese e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë znj. {...}, e cila është inspektore pranë Zyrës së Inspektorit.

Ndërkohë që nga ana e magjistratit nuk është paraqitur/ardhur dhe nuk ka sjellë asnjë përfaqësues edhe pse ka marrë dijeni mbi zhvillimin e seancës së sotshme dëgjimore.

Atëherë, pa humbur kohë, duke zbatuar rregulloren dhe ligjin, unë fillimisht kërkoj që t'ia jap fjalën përfaqësueses, inspektore znj. {...}, shkurtimisht lidhur me qëndrimin që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbi fillimin e këtij procedimi.

{...}: Parashtrësë (Shkurt) e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë regjistruar disa praktika të krijuara nga ish-Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vendimin nr. 1245/2018, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}, {...}”.

Gjithashtu, praktikë e KLD-së ka qenë edhe praktika tjetër në lidhje me vendimin {...}, datë 27.09.2023. Kanë pas të njëjtin objekt që kanë qenë në lidhje me zvarritjen në zbardhjen e vendimeve dhe me vendimin 105 datë 09.02.2023 Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Gjithashtu, duke qenë që ka pasur disa praktika të tjera të ish-KLD-së që kanë qenë në proces të hetimit disiplinor si dhe në proces të verifikimit ka vazhduar Inspektori i Lartë i Drejtësisë me bashkimin e procedimeve hetimore ndaj veprimtarisë së gjyqtarit të shkallës së parë {...}, {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Nga të gjitha praktikat e ndjekura, kanë qenë edhe praktikat të cilat kanë qenë në procese verifikimi, siç është ankesa e shtetasit {...}, edhe kjo ka qenë e dërguar për kompetencë nga Ministria e Drejtësisë ndaj veprimtarisë së magjistratit {...}.

Me vendimin nr. {...} prot., datë 31.03.2022 Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka vendosur verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga Ministër i Drejtësisë, për të njëjtën shkelje të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016, dispozitë e cila parashikon si shkelje disiplinore, vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve ose të akteve procedurale.

Inspektori i Lartë të Drejtësisë gjithashtu ka vazhduar me vendimin për bashkimin e praktikave të verifikimit dhe hetimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, si dhe në fund ka qenë edhe praktika e ish-KLD-së e cila ka qenë një praktikë për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...} dhe gjyqtarit {...}, praktikë e cila ka filluar mbi bazën e ankimit të shtetasit {...}.

Të gjitha ankesat në lidhje me gjyqtarin {...} kanë të bëjnë me pretendime për zvarritje të gjykimit të çështjeve administrative ku ankuesi {...} ka qenë me cilësinë e palës paditëse.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim ka vendosur vazhdimin e hetimit disiplinor dhe dy vendimet e mësipërme ka rezultuar, duke qenë se kemi të bëjmë me të njëjtin gjyqtar, për të njëjtin shkak dhe për të njëjtën shkelje që parashikohet nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”,

ka vendosur bashkimin e procedimeve hetimore, të vendimit 105 dhe vendimit 2789.

Në analizë të të gjitha elementëve faktikë dhe juridikë të cilat përcaktojnë ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, nga të gjithë provat e administruara, rezulton se nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik, i cili dikton mbylljen e këtij hetimi disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b”, “ç”, “d”, “dh”, nenit 134, pika 1, të ligjit nr. 96/2016.

Nga provat e administruara gjatë hetimit disiplinor rezulton se veprimi apo mosveprimi i magjistratit {...} nuk është i natyrës që lidhet vetëm me vlerësimin profesional të tij, por në rastin konkret konstatohet ekzistenca e elementëve të shkeljeve disiplinore, që janë të parashikuara në nenin 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016.

Nga veprimet hetimore të kryera si dhe nga provat e administruara gjatë hetimit disiplinor, ka rezultuar se gjyqtari {...} në përfundim të gjykimit të çështjes objekt hetimi disiplinor ka disponuar me vendimin nr. {...}, datë 24.06. të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}, për rrëzimin e padisë së paditësit {...}.

Nga fleta e regjistratit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në kryesekretari, rezulton se vendimi është arsyetuar dhe dosja është dorëzuar për një afat 9 (nëntë) muaj dhe 5 (pesë) ditë me vonesë.

Rezulton gjithashtu që magjistrati {...} ka zbardhur me vonesë gjatë periudhës mars 2018, 3 vendime për një periudhë 1-mujore, si dhe në tërësi 7 vendime 2 muaj, 9 vendime për një periudhë 3-mujore, 12 vendime për një periudhë 4-mujore dhe një vendim për një periudhë 6-mujore.

Gjithashtu, rezulton që magjistrati {...} ka zbardhur me vonesë gjatë periudhës 24.06.2021 - 29.07.2021 dhe 30.03.2022, 12 vendime për një periudhë 1-mujore, 6 vendime për një periudhë [...], në vazhdimësi, dhe pjesën më të madhe e ka 52 vendime për një periudhë 5-mujore, 12 vendime për një periudhë 6-mujore, dhe duke vazhduar çdo muaj me një mesatare 9, 10, 12 vendime dhe në përfundim ka 9 vendime për një periudhë 11-mujore dhe 12 vendime për një periudhë 26-mujore (më shumë se dy vjet).

Nga provat e administruara rezulton se gjyqtarit {...} nëpërmjet mosarsyetimit të vendimit nr.514, datë 24.06.2021, si dhe vendimeve të administruara për periudhën mars,

viti 2018, si dhe periudhës 24.06.2021 - 29.07.2021, deri në 30.03.2022, në afatin e parashikuar nga ligji ka vepruar me vonesë tej çdo afati të arsyeshëm e cila ka sjellë si pasojë zvarritjen e pajustificuar të proceseve gjyqësore, si dhe kryerjen e veprimeve procedurale në kuadër të këtyre proceseve.

Në analizë të përgjithshme të kriterit të “shkallës së fajësisë dhe motivi”, nga të dhënat si dhe provat e grumbulluara gjatë hetimit disiplinor, provohet se veprimet e magjistratit {...} janë kryer të paktën me pakujdesi në formën e neglizhencës e ardhur si pasojë e ngarkesës, e përsëritur në rastet e analizuara hollësisht më lart. Nuk u provua që këto vonesa të jenë kryer më dashje me qëllim krijimin e vonesave për palët për të ushtruar ankim ndaj vendimmarrjeve të gjyqtarit {...}, apo për qëllime të tjera.

Në analizë të kriterit të “pasojës së shkeljes” në raport me faktet e provuara gjatë procesit të hetimit disiplinor, rezulton se si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit është cenuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cenuar besimi i publikut tek drejtësia.

Respektimi i afateve të arsyetimit dhe të gjykimit kanë një rëndësi themelore për garantimin e së drejtës së një procesi të rregullt ligjor dhe në veçanti të afatit të arsyeshëm. Vonesa të tilla kanë të bëjnë me procesin e rregullt gjyqësor, si dhe duke i cenuar të drejtën palëve për një vendim të arsyetuar dhe për të bërë ankim, duke dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë.

Në analizë të kriterit “masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se rreziku evident është vonesa në ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe mundësia e një drejtësie të mohuar.

Duke mbajtur në konsideratë të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} të cilat përbëjnë shkeljen disiplinore, parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në rastin konkret përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur/e lidhur me ekzistencën e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit, në përputhje me parimin e drejtësisë, objektivitetit, individualizimit të masës disiplinore, në vlerësim të: (i) të gjitha

fakteve dhe analizës ligjore [...]; në lidhje me masat disiplinore, masat më të lehta disiplinore janë të papërshtatshme për rrethanat e shkeljes disiplinore, dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me një shkelje të rëndë disiplinore.

Në analizë të identifikimit të të gjithë elementëve juridikë dhe faktikë që justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, në tërësinë e të gjitha pikave të parashikuara nga neni 134, pika 1, shkronja “a”, 138, 142, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, arrihet në konkluzionin se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kërkon fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 1 shkronjat “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016, të vendosë:

“Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 102, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe “Caktimin ndaj magjistratit {...} të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra””.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë nga kolegët kemi ndonjë pyetje?

Po, Markelian!

Markelian Koça: Përshëndetje!

Unë desha të pyes, ju keni bërë një analizë statistikore të çështjeve, në kuptimin

që cili ka qenë numri total i çështjeve të përfunduara nga magjistrati për çdo vit ku pretendohen vonesat? Numrin e gjyqtarëve që kanë qenë dhe kanë punuar normalisht në gjykatë, cili është numri i miratuar statistikisht dhe numri efektivisht i gjyqtarëve? A ka një ngarkesë mesatare që keni marrë në konsideratë që është e pranueshme për një gjyqtar të shkallës së parë të gjykatës administrative? Dhe a ka një analizë të çështjeve të dorëzuara me vonesë nga pikëpamja e objektit? Mora situatën e 26 muajve, janë “pushime gjykimi” apo janë “urdhra ekzekutimi” apo janë vendime themeli?

{...}: Faleminderit!

Atëherë, duke iu referuar, dhe në përgjigje të pyetjes, ne të gjitha të dhënat i kemi marrë përsëri nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë {...}, ku ka rezultuar se për periudhën konkrete kemi marrë nga data 20.07.2020 deri në 31.12.2021, janë shortuar pranë gjyqtarit {...} 434 çështje, përfshirë “kërkesëpadi”, “kërkesa të veçanta”, “urdhra ekzekutimi”. Gjithashtu, gjatë periudhës 01.01.2021 dhe 29.07.2021 janë shortuar pranë këtij gjyqtari 428 çështje, përfshirë “kërkesëpadi”, “kërkesa të veçanta”, “urdhra ekzekutimi”. Në lidhje me vendimet e arsyetuara dhe të dorëzuara në sekretari rezulton se gjatë kësaj periudhe 24.06.2021 – 21.07.2021 janë dorëzuar 76 vendime dhe gjatë periudhës 29.07.2021 dhe 30.03.2022 janë dorëzuar gjithsej 180 vendime. Dosjet e mbartura nga gjyqtarë të cilët janë shkarkuar me vendim KPK-je dhe janë shqyrtuar pranë gjyqtarit {...}, janë 67 dosje.

Gjykata, në përgjigjen që na ka dhënë dhe në pjesën që ne kemi vajtur vetë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ku ka këqyru regjistrin dhe ka administruar vendimet të gjitha, nuk ka një informacion në lidhje me shkaqet që kanë ndikuar në dorëzimin me vonesë të vendimeve të arsyetuara, pasi prej datës 29.07.2021 gjyqtari {...} nuk e ka ushtruar më detyrën pranë kësaj gjykate.

Nga të gjitha aktet kemi administruar, rezulton se afati i arsyetimit të vendimeve të shpallura nga periudha e mësipërme ka rezultuar (ne i kemi marrë të administruara, e keni në raport, të gjithë vendimet), dhe bëhet fjalë, kemi administruar rreth 292 vendime (është në faqen 25 të raportit). Në këto 292 vendime, gjyqtari subjekt i hetimit disiplinor ka shpallur vetëm dispozitivin e vendimit duke i dorëzuar të arsyetuara në sekretari në

kohë dhe në dinamikë për periudha të gjata kohore, tej afateve procedurale dhe pak a shumë kemi marrë masën më të madhe, që janë 11 muaj, janë zbardhur 9 vendime; dhe 12, 26 vendime (këto të fundit vendime themeli, Pasi i kemi të administruara) (në relacionin e ILD-së citohet: “12 vendime për një periudhë 26 mujore”).

Nga aktet gjithashtu ka rezultuar se në muajin mars 2018, për të cilin ka filluar hetimi disiplinor nga ish-Inspektorati i KLD-së rezulton se në këtë muaj, gjyqtari {...} ka dorëzuar pa shpallur, ka shpallur vetëm dispozitivin, rreth 32 vendime jashtë afatit me një periudhë kohore 4 muaj deri në 6 muaj vonesë. Këto vendime janë vendime themeli, për të cilat është ushtruar ankim më pas në gjykatën e apelit, të cilat janë të administruara dhe janë bashkëlidhur këtij hetimi disiplinor. Duke pasur parasysh edhe shkakun sepse ka qenë një hetim disiplinor i cili ka përfshirë dy hetime disiplinore të filluara nga ish-KLD-ja, të cilat duke iu referuar dispozitës kalimtare në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në vitin 2021 dhe momentin që erdhën edhe inspektorët në vitin 2022, ne kaluam me vazhdimin e këtyre hetimeve, ndërkohë kishim edhe të gjitha verifikimet të cilat ishin pjesë e ish-praktikave të KLD-së që më vonë kaluan në një hetim disiplinor.

Pak a shumë ajo ishte ngarkesa e gjyqtarit {...}.

Gjithashtu, në përgjigje të kërkesave që Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë {...}, në lidhje me 38 vendime të dorëzuara me vonesë për muajin mars 2018, për shkak se 38 vendimet ishin vendime themeli (një pjesë e këtyre vendimeve kishte të bënte me rrëzimin e kërkesëpadisë nga palët), dhe për këtë periudhë, për të parë sa ishte ngarkesa e gjyqtarit, sa vendime ka zbardhur, vonesat në lidhje me këto vendime, ka rezultuar që gjyqtari {...} ka dorëzuar, pra ka zbardhur 629 vendime, sipas librit të dorëzimeve bashkëlidhur të gjithë dokumentacionit, duke administruar kopjet e vendimeve, regjistrin, vendimet e zbardhura gjatë periudhës janar-qershor 2018, për të cilën edhe ish-Inspektorati i KLD-së ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor.

Gjithashtu, në lidhje me informacionin me ngarkesën e gjyqtarit {...}, duke i ndarë, duke i cilësuar vendimet që ka dhënë, ka rezultuar se ka shpallur gjithsej 208 vendime themeli, ku këto vendimet e mësipërme që përsëritëm, të cilat janë zbardhur me vonesë, i përkasin 208 vendimeve, 38 urdhra ekzekutimi dhe 31 kërkesa civile.

Ndërsa për dy vendimet për të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor, kanë të bëjnë me dy ankime, një ankim të Ministrit të Drejtësisë (që e përmendëm më parë) dhe një ankim të shtetasit {...}, në lidhje me zbardhjen 9 muaj me vonesë. Është administruar komplet praktika si dhe ankimi që shtetasi {...} ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit.

Gjithashtu edhe me ankesën e shtetasit {...}, edhe pretendimet e shtetasit {...} për zbardhjen me vonesë të vendimit të tij, ai ka qenë në cilësinë e palës paditëse, bëhet fjalë për 11 muaj, është vendimi 514, 24.06.2021, është vendosur “Rrëzimi i kërkesëpadisë” (ka qenë një çështje tjetër) dhe edhe kjo është një dorëzim me vonesë.

Ridvan Hado: Më fal inspektore, të të pyes: Kush është statusi i magjistratit {...} sot, është në detyrë?

{...}: Statusi i magjistratit {...} është status “i pezulluar”. Magjistrati {...}, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është shkarkuar nga detyra; ka paraqitur ankim pranë Komisionit (KPA-së) dhe statusi tani është “i pezulluar”.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Çfarë mendimi ke lidhur me vazhdimin?

{...}: Tani, duke ndjekur edhe praktikën e konsoliduar që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me rastet e magjistratëve të cilët janë me status “të pezulluar”, mendojmë që të vazhdojmë me praktikën që ka KLGJ-ja.

Naureda Llagami: Nejse, për t’u kthyer tek zoti Markelian, e morët informacionin që...?

(Zoti Koça pohon.)

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit për sqarimet!

Mund të vazhdoni për të lejuar Këshillin në vendimmarrje.

{...}: Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, fjalën ia japim relatorit të çështjes që është z. Ridvan Hado, i cili shkurtimisht për çështjen do të na japi edhe propozimin, si e mendon ai si relator i çështjes.

Ridvan Hado: Referuar faktit që me vendimin nr. 428, datë 29.07.2021, magjistrati z. {...}, është shkarkuar nga detyra si gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, nisur edhe nga praktika që ka mbajtur ky Këshill në të gjitha rastet paraardhëse të ngjashme me rastin në fjalë, do t'i propozoj mbledhjes plenare (në kushtet kur magjistrati e ka ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit), pezullimin e procedimit disiplinor me nr. 4/2023, të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar pranë gjykatës që sapo citova, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 428, datë 29.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hado!

Atëherë, hedhim në votim propozimin e relatorit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 4/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 428, datë 29.07.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.

Kopje e këtij vendimi i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

(Futet në sallën e mbledhjes anëtari z. Kurushi, i cili ishte i pranishëm nëpërmjet platformës “online”).

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.12.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime korrente, në buxhetin e vitit 2023, për sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit/ Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 12:29.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtoej e dyta sipas rendit të ditës.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.*
5. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përherëshme në Këshill.*
6. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
7. *Valbona Bala, eksperte EWMI-INL.*
8. *Klodiana Vogli, përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.*
9. *Arben Lila, përfaqësues i EU4JUSTICE.*
10. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*
11. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime korrente, në buxhetin e vitit 2023, për sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit/Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për detajimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime korrente, në buxhetin e vitit 2023, për sistemin gjyqësor, çështje e cila ka ardhur si pasojë e miratimit të VKM-së nga ana e Këshillit të Ministrave, që i atribuohen institucioneve të drejtësisë

një pjesë të shpenzimeve në llojin e pagave, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të 2023-it, duke i dhënë pagat e prapambetura. Në mënyrë më të detajuar, fjalën ia jap drejtorit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë, sikurse jeni në dijëni, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, pas kërkesës së paraqitur nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, ka vendosur pranimin e kërkesës duke shfuqizuar, ndër të tjera, nenin 12, pika 5, shkronja “a” të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe ndaj Këshillit të Lartë Gjyqësor janë ngritur shumë padi, pranë gjykatës administrative, me objekt përfitimin e diferencës së pagës referuese bazë, nga 1 janar 2019 e në vazhdim, sipas rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe arsyetimit të bërë në vendimin e saj nga Gjykata Kushtetuese.

Ndodhur në këtë situatë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në vendimin nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimmarrjeve të gjykatës administrative, me vendimin nr. 661, datë 02.11.2023, ka vendosur që përlllogaritja e pagës referuese bazë e magjistratit (gjyqtar) të bëhet sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për periudhën 1 janar 2019 – deri me datë 8 janar 2023.

Pas një analize të situatës buxhetore aktuale, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim edhe me të gjithë gjykatat, duke u mbështetur edhe në akordimin e një fondi shtesë në shpenzime personeli për vitin buxhetor, në vazhdim 2023, efekti financiar i përlllogaritur si rezultat i ndryshimit të pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtarit) në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për periudhën 1 janar 2019 – 8 janar 2023, për të gjithë magjistratët dhe jomagjistratët të cilët preken nga ky vendim, rezultoi përafërsisht në shumën prej 700,000 mijë lekë.

Për këtë qëllim bazuar në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kërkuar disa herë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, marrjen e iniciativës ligjore

për miratimin e fondeve shtesë, për vitin buxhetor 2023 ose 2024, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, në shumën 700,000 mijë lekë, të ndara këto në dy programe buxhetore, në programin 01110 dhe në programin 03310.

Në vijim të kërkesave tona të vazhdueshme, me vendimin nr. 755, datë 20.12.2023 “Për një shtesë në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, janë miratuar fonde shtesë në shpenzime korrente në grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, për vitin buxhetor 2023, në shumën prej 350,000 mijë lekë.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 20.12.2023, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, i propozon seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e detajimit të fondeve buxhetore shtesë në shumën 350,000 mijë lekë, në shpenzime korrente të detajuara në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese sipas pasqyrave përkatëse bashkëlidhur.

Dua të shtoj këtu se në pasqyrën nr. 2 (të cilat u janë dërguar anëtarëve) është bërë një ndryshim në detajimin e shpenzimeve në 602, pasi Gjykata e Lartë, në e-mailin e datës 22.12.2023 ka konfirmuar se ka mjaftueshëm fonde në 602 dhe s’ka nevojë për fonde shtesë. Këto fonde u janë detajuar gjykatave të tjera të cilat kishin nevojë.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë pyetje për sqarim, përveç atyre që i kemi bërë në mënyrë informale drejtorit?

(Nuk ka pyetje.)

Nëse nuk kemi, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Departamenti.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë znj. Fatmira, se pati një problem mikrofonit. Të lutem edhe një herë, se nuk u dëgjua votimi.

Fatmira Luli: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Po! Ndjesë Klodi!

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e detajimit të fondeve buxhetore shtesë, në shpenzime korrente, në buxhetin e vitit 2023, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrave përkatëse bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, 5 minuta pushim.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.12.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar”.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 12:29.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Gentiana Muçaj*** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

10. Markelian Koça (anëtar)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit të Kryetares së Këshillit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte EWMI-INL.

7. Klodiana Vogli, përfaqësuese e Ambasadës Amerikane.

8. Arben Lila, përfaqësues i EU4JUSTICE.

9. Edmond Hoxhaj, BIRN.

10. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar”.

(Rifillon mbledhja plenare pas disa minutash pushim.)

Naureda Llagami: Atëherë, çështja e tretë por jo më pak e rëndësishme për ditën e sotshme ka të bëjë me ndryshimin e vendimit nr. 13, datë 18.01.2019, “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”. Në fakt, duke qenë se një pjesë e anëtarëve të Këshillit (gjyqtarë), pra tre gjyqtarët janë larguar dhe kanë ardhur gjyqtarët e rinj, por kjo nuk përkon në fakt dhe me ndryshimin e tre anëtarëve jogjyqtarë, që normalisht do krijonte mundësinë që të kishim një përbërje të ndryshme të Këshillit, pra duke qenë se

proceset janë në vijimësi mbi zgjedhjen e anëtarëve jogjyqtarë. Ajo që unë në fakt, në cilësinë e Kryetares, për menaxhimin e punës, i propozoj Këshillit që duke mos dashur që së pari, të prishim ritmin e punës, vijimësia e punës është shumë e rëndësishme, sepse siç e dini Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shumë ngarkesë dhe ndryshimi i komisioneve në kulmin e ngarkesës pa diskutim krijon një lloj ngadalësimi, krijon ngadalësim me prurjet e reja që duan kohën e vet për të kuptuar dhe për të analizuar dinamikën e Këshillit, dhe më pas kemi një ndryshim rrënjësor të Komisioneve; e dyta më pas, ajo që është e rëndësishme që kam marrë parasysh është edhe koha e shkurtër që është presupozuar, duke qenë se fillon procedura parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve jogjyqtarë, por nga ana tjetër marrim parasysh edhe faktin që ligji ka vënë një afat ekskluziv mbi ndryshimin e komisioneve, që minimumi duhet të jetë 2 vjet e gjysmë dhe përbërja e këtyre komisioneve që ne kemi nuk e ka mbushur kohën 2 vjet e gjysmë.

Për këto që them më lart, unë në fakt ju propozoj dhe mbetet në vlerësimin tuaj që anëtarët gjyqtarë të zëvendësohen edhe për nga përkatësia që vijnë dhe përfaqësojnë gjyqësorin, ish-anëtarët e tjerë.

Që do të thotë: Zonja Emona Muçi të jetë pjesë, anëtare e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional; zonja Genta Muçaj të jetë pjesë (duke qenë se është gjyqtare e Tiranës dhe zëvendëson zotin Dritan Hallunaj) e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës; dhe zoti Markelian Koça, duke qenë se është gjyqtar i Gjykatës së Durrësit, të zëvendësojë (gjithmonë janë përkohësisht) znj. Marçela Shehu tek Komisioni i Disiplinës.

Nëse nga ana e Këshillit votohet kjo, më pas kalohet tek propozimet për anëtarët zëvendësues.

(Zoti Toro merr fjalën.)

Alban Toro: Kjo praktika që bazohet tek testamentet që kush ikën do të lërë edhe pasuesin e vet, nuk më përkon shumë, sepse nuk është se është ndjekur në eksperiencën, me sa mbaj mend unë. Në përgjithësi unë i besoj/marr eksperiencën si kriter, si indikator, sepse eksperiencia ka treguar që është mësuesi më i pagabueshëm dhe i besueshëm në çdo

lloj praktike dhe burim informacioni; dhe në kushtet kur KZHK-ja është një nga komponentët e Këshillit i cili ka një ngarkesë relativisht të madhe, ka një punë voluminoze dhe specifike dhe prodhues produktesh të pjesës më të madhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për këtë qëllim unë do të besoja tek eksperiencia dhe do të mendoja që ky indikator të ishte baza për përzgjedhjen apo për të marrë preferencat, që s'janë marrë, të anëtarëve. Normalisht ligji na ngarkon të dëgjonim edhe preferencat paraprakisht, pra t'i kishin nënshkruar për aq sa është e mundur.

Kështu që në këto kushte unë propozoj që Markeliani të jetë tek KZHK-ja (anëtar i KZHK-së), Gentiana tek vlerësimi, sepse ka një eksperiencë relativisht dhe vjen e dyta pas Markelianit dhe përfundimisht pastaj me Ridvanin tek disiplina (*lapsus emri i z. Hado*), Emona. Kështu që ky është propozimi për tre anëtarët e rinj që janë integruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Në fakt, nuk është se s'e kemi marrë parasysh, kam marrë parasysh jo vetëm aspektin e prejardhjes nga gjykata, por kam marrë parasysh edhe nivelin e apelit, duke qenë se zonja Muçi vjen nga niveli i apelit dhe ne e dimë që në shpërndarjen që i bëjmë komisioneve, gjithmonë kemi parasysh që të kemi një balancë edhe të gjykatave që përfaqësojnë (duke qenë se është nivel apeli me nivel joapeli). Megjithatë unë mendoj që të hedhim në votim, praktikën e kemi, fillon propozimi i Albanit dhe më pas propozimi im.

Po! Paskemi tre propozime.

(Edhe zoti Kurushi kërkon fjalën.)

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Unë dakordësohem pjesërisht në propozimin e Kryetares dhe pjesërisht në propozimin e z. Toro. Kështu që, thashë të bëj një propozim timin. Mbase mund të jetë më i përshtatshëm për të gjithë ne. Edhe propozimi im mbështetet duke marrë në konsideratë kriteret e propozuara si nga Kryetarja ashtu edhe nga zoti Toro, pra i) pozicioni, që propozon Kryetarja të merret si kriter, dhe unë besoj se duhet të merret si

kriter dhe ii) përvoja, që është kriteri tjetër të cilin e bën si propozim z. Toro.

Në këtë aspekt, unë do të propozoja, duke ruajtur vazhdimësinë edhe pozicionet, do propozoja që zonja Muçi të jetë anëtare e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Përvojës Profesionale; zoti Koça, në vlerësimin tim, referuar përvojës që thotë zoti Toro, por marrim në konsideratë edhe faktin që ka qenë pjesë e skemës së delegimit dhe zoti Koça ka punuar edhe për një farë kohe në Gjykatën e Apelit Durrës (pra edhe një përvojë tjetër shtesë) dhe unë mendoj që mund të na japi një suport/një ndihmë për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës referuar përvojës dhe pozicioneve ku ai ka ushtruar funksionin si magjistrat; dhe zonja Muçaj unë mendoj të shkojë tek komisioni i tretë që është Komisioni i Disiplinës.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit Klodi!

Atëherë, t'i kalojmë në votim të tre.

Fillojmë me votimin e Klodit (po e marrim nga fundi). Klodi thotë: znj. Muçi...

Në fakt Klodi, ne bashkë kemi vetëm një ndryshim. Atëherë, unë them, duke qenë se propozimi i Albanit është komplet ndryshe, tek ndryshimi ynë, ne hedhim në votim propozimin tim, nëse s'i merr votat, pastaj kalon propozimi yt. Se me Albanin e kemi totalisht ndryshe.

Hedhim në votim propozimin e Albanit.

(Zonja Kryetare sqaron çështjen e propozimeve me znj. Luli, duke u shprehur se ndryshimi i propozimeve të saj dhe z. Kurushi është vetëm tek Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.)

Naureda Llagami: Fatmira, propozimi do të ecim sipas praktikës. Kalon Albani dhe unë dhe Klodi do të bëhet propozimi për KZHK-në, siç thua ti.

Kalojmë tek propozimi i Albanit, i cili është ndryshe nga propozimi i Klodit dhe nga propozimi im, ku propozon që zonja Muçi tek disiplina, propozon z. Koça tek zhvillimi i karrierës dhe Gentën tek vlerësimi?

E hedhim në votim.

Propozimi i Albanit: znj. Muçi tek disiplina, znj. Muçaj tek vlerësimi profesional, është dhe z. Koça tek zhvillimi i karrierës. Nuk ka lidhje as me propozimin tim, as me

propozimin e Klodit. Je e qartë tani?

Kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Kundër propozimit të zotit Toro.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi me 7 (shtatë) vota kundër.)

Naureda Llagami: Kalojmë tani, këtu mund të kalojmë me emra, duke qenë se ne ramë dakord. Kalojmë me emra. Atëherë, për zonjën Muçaj, propozimi im bashkë me propozimin e Klodit është i njëjtë, që duhet të jetë tek Komisioni i Vlerësimit...

Klodian Kurushi: Për zonjën Muçi, jo Muçaj.

Naureda Llagami: Ndjesë, Muçi. E hedhim në votim këtë gjë. Tek Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional zonja Emona Muçi.

Ilir Rusi: Dakord me këtë propozim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Nuk dëgjohet vota.

Ridvan Hado: Nuk dëgjohet vota. *(Dy anëtarëve që nuk u është dëgjuar vota për shkak të ndonjë defekti teknik gjatë votimit janë njoftuar nëpërmjet e-mailit. Nëpërmjet e-mailit, zoti Hado ka konfirmuar votën "dakord". Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek zoti Koça, në të cilin Klodi, duke qenë se je propozim ndryshe, propozon që zoti Koça të jetë tek Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Hidhet ky propozim në votim.

Ilir Rusi: Kundër këtij propozimi.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

(Me 6 (gjashtë) vota pro, miratohet propozimi i zotit Kurushi.)

Naureda Llagami: Atëherë, zonja Genta kalon automatikisht tek Komisioni i Disiplinës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi.)

Naureda Llagami: Atëherë, lidhur me anëtarët zëvendësues. Duke qenë se propozimi që kemi tashmë është me propozim të z. Kurushi, z. Ridvan Hado të jetë tek Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke qenë se ka praktikë. Tek Komisioni i Disiplinës propozimi është që zonja Genta Muçaj, anëtare e Komisionit të Disiplinës, të jetë anëtare e Komisionit të Planifikimit Strategjik (zëvendësuese). Dhe zonja Emona Muçi do të jetë... Genta do të jetë anëtare edhe e përhershme e Komisionit të Planifikimit Strategjik, duke qenë se je e disiplinës edhe kalon aty tek ne, për shkak edhe të ngarkesës së pakët që ka disiplina. Dhe zonja Emona Muçi do të jetë anëtare zëvendësuese e Komisionit të Disiplinës, më fal, anëtare zëvendësuese e Komisionit të Planifikimit Strategjik. Ndërkohë që, tek Komisioni i Disiplinës, tashmë do të jetë zoti Markelian Koça anëtar zëvendësues, duke qenë se je tek karriera. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi.)

Naureda Llagami: Atëherë, me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot. Mirë u takofshim! Mund të kemi edhe një mbledhje, siç ju thashë, një mbledhje “online”, për pjesën e shpërndarjes së buxhetit, për ta mbyllur vitin 2023.

Për ato që nuk takohemi: Gëzuar!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor